



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .02.2025

**MBLEDHJA Nr. 08,  
Datë 10.02.2025, ora 12:00  
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 10.02.2025, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 08 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 03.02.2025.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime për vitin 2025.
3. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin janar 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
4. Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike për vitin 2024.
5. Mbi shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE nr. 302, datë 30.12.2024, “Mbi shqyrtimin e propozimit të FTL sh.a. për draft marrëveshjen për blerjen e energjisë elektrike ndërmjet Furnizuesit të Tregut të Lirë sh.a. dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë”.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 263, datë 02.12.2024.
8. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**